



SUKSESI SIGUROHET ME PJESËMARRJE



DEMOKRACINË E BËJMË NE QYTETARËT

OLTI (11), ELJESA (10), LEJLA (10), ERIONA (10), OLISA (11), ADEA (11), MALSOR (10), OMER (10),

GRANIT (9)



Të kuptosh se çka vërtet nënkupton fjala demokraci do të thotë të kuptosh se çfarë roli kanë qytetarët në vendimmarrje

Unë kam vlerë sepse kam kuptuar se kam të drejta të shumta dhe ato më respektohen nga të gjithë. Të drejtën e shprehjes së lirë e kam që nga dita kur kam lindur. Gjithashtu, kur jam bërë pjesë e sistemit edukativo-arsimor kanë vazhduar të më respektohen edhe më shumë të drejtat e mia. I mbaj mend rastet kur

Duke u rritur dhe duke fituar njohuri, kuptuam se je-tojmë në një shteti demokratik. E përparësitë e shtetit demokratik janë: liria e të shprehurit, toleranca, barazia, respekti, solidariteti, zgjedhja e lirë e shumë të tjera. Për këtë jemi shumë të lumtur që kemi kaq shumë liri për të vepruar dhe për të fuqizuar demokracinë. Vetë fakti që sot kemi ardhur në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“, dëshmon nevojën e secilit qytetar për të mësuar më shumë për këtë sistem të qeverisjes.



Ne do ta zhvillojmë demokracinë e vendit tonë

Ne jemi shumë të kënaqur që ekzistojnë mundësi të tilla që i stimulojnë nxënësit kosovarë që të bëhen zbatues të përpiktë të elementeve të demokracisë. Prandaj, me gjithë respektin që kemi ndaj jush, ju ftojme që të jeni ju ata të cilët e mbani dhe e zhvilloni sistemin demokratik. Gjithmonë ka hapësirë për ndryshime. Ndryshimet mund t'i arrijmë së bashku me punë dhe me përkushtim.

ishim në klasën e parë dhe unë dhe klasa ime që nga atëherë votoam. Ishte ndjenjë shumë e veçantë kur secili nga ne ishte i lirë të votoj. Nga mendimet tona u zgjodhën përfaqësuesit e klasës. E gjithë kjo nuk ka ndodhur rastësisht. Mirëpo, atëherë ishim të vegjël ta kuptonim se nga ishte prejardhja e tërë këtij respekti, e të drejtës për tu shprehur lirshëm, e të drejtës për të zgjedhur lirshëm, etj.



Demokratët e vegjël

NE QYTETARËT E VEGJËL, POR SHUMË AKTIV

FLORENT (11), MERIS (10), LEON (10), OMER (10), SOMEA (10), LEONORA (10), ARBENITA (11),

AMIR (9)



Ne, grupi i gazetarëve të rinjë premtojmë se gjithmonë do të jemi qytetarë aktiv. Vetëm në këtë mënyrë mund t'i ndihmojmë vendit tonë

Për të qenë qytetarë aktiv duhet të sillemi mirë dhe të veprojmë në të mirë të vendit tonë.

Çka na bën neve qytetarë aktiv? Ne duhet të sillemi mirë me të moshuarit dhe me të varfërit. Nëse jemi në autobus duhet t'iu ndihmojmë të moshuarve ose nëse kanë shumë qese në duar duhet t'ua lëshojmë vendin. Vetëm fjala qytetar dallon shumë nga qytetari aktiv. Në vendin tonë për shembull, të gjithë jemi qytetarë të Republikës së Kosovës, por jo të gjithë janë aktiv. Ne mund të flasim për problemet që i ka secili prej nesh në lagjet tona. Si grup u pajtuam se në secilën prej lagjeve tona mungon një park për të luajtur fëmijët dhe për t'ua relaksuar qytetarët e tjerë të lagjes. Por, janë dy mënyra se si mund të bëjmë një park në lagje. E para dhe ndoshta më vështirë e realizuesh-

me është që qytetarët e lagjes ta ndërtojnë vetë atë. E dyta është që ne të kërkojmë nga komuna jonë që të ndërtojnë një park. Në fakt, opsioni i parë merret parasysh vetëm nëse nëse bë asnjë mënyrë komuna



nuk ka mundësi ta ndërtojë. Pa marrë parasysh se si do të ndërtohet parku, nga banorët e lagjes apo nga komuna, ky është një shembull i qytetarisë aktive. Banorët kanë shprehur vullnetin e mirë që ta kenë një park dhe t'ia shtojnë vlerën komunitetit ku banojnë.



Qytetarë aktiv na bënë edhe pjesëmarrja në zgjedhje



Ne flasim për qytetarinë aktive

MËNYRA E VOTIMIT

EDMOND (10), SUAD (10), XHENETA (10), ENESA (10), ANTONETA (10), ARDIAN (10), SALAUDIN (10), GIONID (10)



Nëse dëshironi të mësoni më shumë për zgjedhjet, lexojeni këtë artikull të punuar nga duart tona, duart e fëmijëve

Një ditë vere unë po shkoja të zgjedhja diçka për të ngrënë. Vendi ku unë shkoj për të blerë gjëra është tregu i gjelbër. Aty pashë shumë pemë dhe perime që ishin të pjekura dhe dukeshin shumë të shijshme. U afrova dhe mora disa molla. Ato i zgjodha vetë dhe për këtë zgjedhje nuk më detyroi askush. Unë e pyeta shitësin: „A mund t'i kthej ato nëse nuk janë të mira?“ Ai tha: „Po, patjetër që mundesh“. Pas asaj, unë shkova në shtëpi dhe provova një prej tyre. Mollat ishin shumë të mira, ashtu siç e paramendova. U ndjeva shumë kënaq me zgjedhjen time. Zgjedhje të tilla, unë bëj çdo ditë. Mirëpo, për të kuptuar më shumë për zgjedhjet demokratike, vazhdoni të lexoni artikullin. Këtu në Punëtorinë e Demokracisë ne mësuam se fëmijët

nuk kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet komunale dhe zgjedhjet parlamentare. Vetëm qytetarët mbi moshën 18 vjeçare mund të votojnë. Gjatë procesi zgjedhor, një qytetar ka të drejtë të jap votën e tij vetëm një herë e jo dy apo më shumë. Arsyeja pse është caktuar moshë 18 vjeçare është se kur arrijmë këtë moshë, ne jemi më të pjekur, mendojmë më mirë, etj.



Autorë, gazetarë, nxënës dhe demokratë



Në zgjedhje mund të votojnë gratë, të moshuarit, personat me nevojë të veçanta, pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, personat që kanë fe të ndryshme, siç janë feja islame apo feja krishtere, etj.

Në ditën e zgjedhjeve ka shumë persona, të cilët kujdesen që procesi zgjedhor të jetë sa më i mirë. Ky proces është shumë i rëndësishëm për ne, prandaj ne premtojmë se kur ta mbushim moshën e duhur do të votojmë rregullisht.

LIRIA E MEDIAS NË DEMOKRACI

ENDRIT (11), KLEJDINA (10), DRILON (9), ANESA (10), HARIS (10), ANISA (10), ELTRIS (10), ELVANA (10)



Për të kuptuar se si ndikon media në jetën tonë, lexojeni artikullin tonë

Media është mjet informimi e cila ka ndikim shumë të madh në jetën tonë. Por pse media është kaq e rëndësishme për ne? Ne do të marrim disa shembuj se si ka ndikuar media në jetën tonë si shoqëri demokratike. Një shoqe në klasën sonë, duke shikuar filma vizatimorë në televizion, ajo ka arritur ta mësojë gjuhën angleze. Apo në qoftë se mësuesja na jep për detyrë të hulumtojmë për një temë të caktuar, atëherë na nevojitet kompjuteri si dhe çasja në internet. Në rast se një shoqe apo shok i klasës është e/i sëmurë, për t'i treguar se çka kemi mësuar në klasë dhe se çfarë detyrash na ka dhënë mësuesja, atëherë na nevojitet telefoni.

Ka dy lloje të medias: media elektronike dhe media e shkruar. Tek mediat elektronike hyjnë: telefoni, televizioni, radio, kompjuteri, tableti, etj. Ndërsa tek media të shkruara hyjnë: librat, gazetat, revistat, etj.




Ne ju sigurojmë të dhëna të sakta, sepse jemi gazetarë të demokracisë

Po të mos ekzistonte media, as ju të dashur lexues nuk do të kishit mundësi ta lexonit këtë artikull.

Siç e pamë, media na sjellë shumë të mira. Megjithatë, duhet të kemi kujdes se sa kohë shpenzojmë para mjeteve elektronike.

Mesazhi ynë për juve është: ta shfrytëzojmë median vetëm për qëllime të mira dhe për të ngritur e për të forcuar elementet demokratike.





IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Hilmi Rakovica“
Klasa: V-3
Vendi: Prishtinë